



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Pozicioni: Lektor/Asistent-Lektor

Fakulteti I Inxhinierisë dhe Arkitekturës

Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

Tipologjia: Me kohë të plotë

Afati i aplikimit: 20.07.2026

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) është një universitet me një përvojë 15- vjeçare i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike & IT. I njohur për qasjen inovative në arsim dhe kërkimin shkencor, UMT është institucioni i parë në Shqipëri që ka integruar Inteligjencën Artificiale në të gjitha ciklet e studimit, Bachelor, Master dhe Doktoraturë, në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare, duke ofruar një formim të orientuar drejt profesioneve të së ardhmes.

UMT është i angazhuar fuqimisht në ndërkombëtarizim, duke ndërtuar partneritete me universitete dhe institucione kërkimore në Europë dhe SHBA, si dhe në krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm inovacioni dhe sipërmarrjeje, që mbështet zhvillimin e ideve dhe projekteve nga studentët dhe stafi akademik.

Në kuadër të zgjerimit të ekipit të tij, UMT fton të aplikojnë kandidatë të kualifikuar, me eksperiencë dhe bashkëpunues për **pozicionin Lektor dhe Asistent-Lektor në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës.**

Kriteret kryesore për të aplikuar për pozicionin janë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë bachelor dhe master shkencor, ose të ketë diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND) në Arkitekturë;
- Të ketë përfunduar studimet doktorale ose të jetë në proces doktorature;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme në mësimdhënie;
- Të ketë eksperiencë në projektimin arkitektonik të tipologjive të ndryshme të ndërtesave, rezidenciale, sociale, kulturore, ekonomike, etj.
- Të ketë njohuri mbi teorinë dhe historinë e Arkitekturës;
- Të jetë i aftë të drejtojë studentët në mësimin e njohurive të reja në fushën e arkitekturës;
- Të jetë i aftë të drejtojë studentët në procesin e hartimit të planeve dhe projekteve të ndryshme arkitektonike;
- Të jetë i aftë të përfshihet në organizimin e aktiviteteve dhe workshopeve që lidhen me fakultetin.



-
- Të jetë i aftë të zhvillojë detyrat administrative që lidhen me aktivitetin e FIA dhe UMT në përgjithësi;
 - Të ketë interes në kërkim shkencor dhe zhvillim profesional në fushën akademike;
 - Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të ekipit;
 - Të ketë aftësi të forta organizative dhe bashkëpunuese;
 - Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikuese;
 - Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Aplikimi

Kandidatët duhet të dërgojnë në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- Letër motivimi.
- CV (Curriculum Vitae) përfshirë listën e botimeve shkencore dhe referimeve në konferenca shkencore brenda ose jashtë vendit.
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit Bachelor dhe “Master i Shkencave”, ose “DIND”.
- Dëshmi e titullit “Doktor i Shkencave” apo tituj të tjerë akademikë, ose vërtetim të ndjekjes së ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”.
- Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent (MAS), ose vërtetim që janë në proces njohje.
- Portofol të punimeve të kryera.

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al